

# STATUT

## I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

### “Albanian Recruitment International”

Në bazë e në zbatim të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar, me poshtë referohet si “Ligji Për Shoqëritë”, veprimtaria e shoqërisë

### “Albanian Recruitment International”

Do të organizohet dhe do të drejtohet sipas këtij Statuti të trajtuar në të njëjtin dokument me Aktin e Themelimit.

### PJESA E PARË DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1 Ortakët

- 1.1 Ortak i vetëm i shoqërisë “**Albanian Recruitment International**” sh.p.k., është:
  1. **Z. Jacques RIZZO**, i biri i **Jean**, shtetas francez, lindur më datë 25 / 11 / 1984 , në Reims, Francë, aktualisht banues në Vlorë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit / Pasaportës francez me nr. 160759501335, (bashkëngjitur kopje e saj), madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar, i cili ka ofruar një kontribut në para të barabartë me **12.000,00 (dymbëdhjetëmijë) Lekë**, të kapitalit fillestar duke depozituar një vlerë të njëjtë në llogarinë e shoqërisë pas formimit dhe zotëron **100 %** të kapitalit të shoqërisë.
- 1.2 Shoqëria do të funksionojë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3 Statuti është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

#### Neni 2 Emri i Shoqërisë, Logo, Vula

Emri i shoqërisë është “**Albanian Recruitment International**” sh.p.k, (në këtë Statut, referuar si “**Shoqëria**”). Shoqëria do të ketë logon, vulën si dhe faqen e saj të internetit, sipas përcaktimeve të Asamblesë së saj.

#### Neni 3 Selia e Shoqërisë

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga “Pjetër Budi”, Nr. 101, Njesia Bashkiake Nr. 2, Kodi Postar 1010, Tiranë, Shqipëri.

- 3.2 Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet vetëm me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 3.3 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë, si edhe jashtë saj.

#### **Neni 4 Forma ligjore**

- 4.1. Shoqëria është shoqëri e së drejtës shqiptare dhe është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- 4.2 Forma ligjore e shoqërisë mund të ndryshohet vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

#### **Neni 5 Kohëzgjatja e Veprimtarisë**

- 5.1. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 5.2 Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

#### **Neni 6 Objekti i aktivitetit**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Agjenci rekrutimi -

### **PJESA II KAPITALI I SHOQËRISË DHE KUOTAT**

#### **Neni 7 Kapitali Fillestar i Shoqërisë**

- 7.1 Kapitali fillestar i regjistruar i Shoqërisë është **12.000,00 (dymbëdhjetëmijë) Lekë** dhe konsiston në **1 (një) kuotë**.
- 7.2 Kontributet e Ortakut përbëjnë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë. Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:
- Z. Jacques RIZZO, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me 12.000,00 (dymbëdhjetëmijë) Leke të kapitalit fillestar, duke depozituar një vlerë të njëjtë në llogarinë e shoqërisë pas formimit të saj.*
- 7.3 Pjesëmarrja e Ortakëve në Shoqëri është në raport me kontributet e tyre dhe vlera nominale e kuotës së secilit Ortak llogaritet në raport me secilin kontribut, e paraqitur si më poshtë:

| Nr.           | Emri i Ortakut   | Kuota          | Vlera (lekë)                                 | Kapitali (%) |
|---------------|------------------|----------------|--|--------------|
| 1.            | Z. Jacques RIZZO | 1 (një)        | 12.000,00<br>(dymbëdhjetëmijë)               | 100%         |
| <b>TOTALI</b> |                  | <b>1 (një)</b> | <b>12.000,00</b><br><b>(dymbëdhjetëmijë)</b> | <b>100%</b>  |

- 7.4 Çdo pjesë e secilit ortak do t'i përgjigjet një vote korresponduese në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve dhe do t'i japë ortakëve të drejtën për të marrë dividendë në rast shpërndarje të fitimit, si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të Shoqërisë.

### **Neni 8 Rritja e Kapitalit**

- 8.1 Kapitali fillestar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë mund të zmadhohet duke emetuar kuota rishtazi, kundrejt kontributeve të reja.
- 8.2 Kalimi i kuotave të reja kushtëzohet nga e drejta e parablerjes në favor të ortakëve ekzistues, sipas procedurës së nenit 10 të Statutit.
- 8.3 Në rast rritjeje të kapitalit, kuotat e ortakëve të Shoqërisë do të rriten sipas shumave të përcaktuara në vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 8.4 Kapitali i regjistruar nuk mund të zmadhohet, nëse nuk janë shlyer ende kontributet për kuotat e nënshkruara më parë.
- 8.5 Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, Asambleja e Ortakëve mund të vendosë t'a zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.
- 8.6 Pjesa e rezervave, si dhe fitimet e pashpërndara, mund të kalohen në kapitalin fillestar.
- 8.7 Rezervat dhe fitimi i pashpërndarë nuk mund të kalohen në kapitalin bazë, nëse bilanci i vitit paraardhës rezulton me humbje.

### **Neni 9 Zvogëlimi i Kapitalit**

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin fillestar me vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Shoqërisë. Në çdo rast kapitali nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve sipas shumave të përcaktuara në vendimin e asamblesë.

## Neni 10

### Transferimi i Kuotave të Kapitalit dhe e Drejta e Parablerjes

- 10.1 Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, sipas nenit 73 të ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuar. Kuotat e kapitalit të shoqërisë fitohen apo kalohen nëpërmjet: (i) kontributin në kapitalin e shoqërisë; (ii) shitblerjes; (iii) trashëgimisë; (iv) dhurimit; si dhe (v) çdo mënyre tjetër parashikuar me ligj. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata do bëhet me shkrim.
- 10.2 Në rast të largimit të plotë prej njërit prej ortakëve nga shoqëria, kuotat e tij i kalojnë menjëherë ortakëve të tjerë në pjesë të barabarta me kontributin e secilit prej tyre.
- 10.3 Në rast transferimi të pjesëve të kuotave të kapitalit në çdo lloj forme në favor të personave të tjerë nga ata të parashikuar më sipër, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim, me çdo kusht, duke përfshirë edhe dhurimin, ortakët e tjerë gëzojnë të drejtën e parablerjes mbi këto kuota kapitali.
- 10.4 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotat e tij të kapitalit duhet t'i njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitjen, çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit të kuotave. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha kuotave të kapitalit të ofruar për shitje.
- 10.5 Ortakët do të kenë në dispozicion 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon pjesën e kuotave të kapitalit, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar dhe/ose nuk nënshkruajnë kontratën e transferimit të kuotave apo dështojnë në shlyerjen e pagesës së çmimit të kuotave brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e letrës rekomande, do të prezumohet se ortakët kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.6 Në rast se oferta pranohet nga një ose disa ortakë, kuotat e kapitalit të ofruara nga ortaku që transferon kuotat e kapitalit, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë më pjesën e kuotave që ata zotërojnë në shoqëri, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 10.7 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes nga ortakët ekzistues, apo nëse ata heqin dorë nga e drejta e tyre e parablerjes, atëherë kuotat e kapitalit të shoqërisë mund t'i transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, pa pasur nevojë për vendim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.
- 10.8 Në rast të transferimit të kuotave të kapitalit për shkak trashëgimie *mortis causa* ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Nëse ortakët e Shoqërisë nuk japin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj kuotat e kapitalit mund t'i transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

### III. TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE, STRUKTURA DREJTUESE

#### Neni 11 Përgjegjësia e kufizuar

Ortakët janë përgjegjës deri në vlerën e pjesës së tyre në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet.

#### Neni 12 Detyrimet e Ortakëve

Ortakët kanë detyrim të paguajnë pjesën e tyre, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë nëse ftohen në mënyrën e duhur, të mbështesin Shoqërinë në kryerjen e veprimeve të saj si dhe të përmbushin vendimet e mbledhjes së ortakëve dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur brenda qëllimit të organit përkatës.

#### Neni 13 Asambleja e Ortakëve dhe të Drejtat e saj

- 13.1 Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.
- 13.2 Asambleja e Ortakëve përbëhet nga të gjithë ortakët e Shoqërisë.
- 13.3 Vetëm Asambleja e Ortakëve ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:
  - (a) ndryshime dhe modifikime të Statutit;
  - (b) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit dhe/ose çdo lloj pagimi të pjesshëm ose subvencionit të dhënë nga ortakët, përveç kur është parashikuar ndryshe në kete Statut;
  - (c) bashkimin, ndarjen, prishjen dhe çdo lloj transformimi të Shoqërisë;
  - (d) blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
  - (e) hapjen dhe mbylljen e degëve dhe zyra e përfaqësimit;
  - (f) pjesëtimin dhe anulimin e kuotave;
  - (g) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - (h) miratimin e raporteve vjetorë dhe bilancit të shoqërisë si dhe shpërndarjen e fitimit;
  - (i) blerjen, shitjen dhe vendosjen hipoteke mbi/të pasurive të paluajtshme;
  - (j) marrjen me qira, dhënien me qira ose dhënien e çdo të drejte për përdorimin e pasurive të paluajtshme dhe ndërtesave;
  - (k) të vendosë për investimet, përfshirë ato (investimet) në teknologji, futjen e linjave të reja teknologjike dhe/ose heqjen dhe/ose modifikimin e linjave ekzistuese;
  - (l) të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të lëshojë garanci ose letra sigurie
  - (m) të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të shoqërisë;
  - (n) Të japë ose të refuzojë miratimin e saj për veprimtarinë e administratorëve që kërkojnë miratimin e Asamblesë sipas Statutit, si dhe të përcaktojë

- shpërblimet për administratorët, të përfundojë kontratat e punës me administratorët dhe nëpunësit ekzekutivë të shoqërisë;
- (o) të japë alternativa, të drejta të ndarjes së fitimit vjetor, pagesave në natyrë, të drejtat mbi pensionet ose çdo pagesë mbi largimin e drejtorëve, dhe nëpunësve ekzekutivë të shoqërisë;
  - (p) të përfundojë marrëveshje konsultimi dhe bashkëpunimi;
  - (q) emërimin dhe shkarkimin e likujduesve, ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - (r) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - (s) përcaktimin e shpërblimeve për likujduesit, ekspertët kontabël;
  - (t) mbikqyerjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët;
  - (u) miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin dhe mbledhjes së asamblesë;
  - (v) përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;
  - (w) përcaktimin e buxhetit vjetor;
  - (x) miratimin e çdo çështje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar asamblesë së përgjithshme në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.
- 13.4 Asambleja e Ortakëve do të ketë të drejtë të vendosë mbi çdo çështje që tejkalon aktivitetin e përditshëm të Shoqërisë.

#### **Neni 14** **Vendimet e Asamblesë së Ortakëve**

Vendimet e përcaktuara në pikat (a), (b), (ç), (d), (g), (j), (k), (l), (n) dhe (r) të nenit 13.3 të Statutit, merren me shumicë të kualifikuar nga ortakët e shoqërisë, sipas kuorumit dhe vendimmarrjes së përcaktuar në nenin 16.2 të këtij Statuti. Për të gjitha çështjet e tjera të listuara në nenin 13.3 të Statutit, vendimet merren me shumicën e zakonshme, sipas përcaktimeve të nenit 16.1 të këtij Statuti.

#### **Neni 15** **Thirrja e Asamblesë së Ortakëve**

- 15.1 Asambleja e Ortakëve do të thirret nga administratorët të paktën njëherë në vit në selinë e Shoqërisë ose në çdo vënd tjetër nëse përcaktohet në njoftim.
- 15.2 Gjithashtu, ortakët të cilet përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për të thirrur Asamblenë. Në kërkesën drejtuar administratorëve mund të përfshihen dhe çështjet e posaçme të rendit të ditës.
- 15.3 Asambleja do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga administratorët, njoftim ky i cili duhet të merret nga përfaqësuesit e ortakëve nëpërmjet një letre rekomande, telexi apo faksi jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes. Njoftimi i shkruar do të regjistrohet në librin e procesverbalit të Shoqërisë. Gjithashtu, Asambleja e Ortakëve mund të thirret nëpërmjet postës elektronike me të njëjtat kushte dhe afate.
- 15.4 Njoftimi për takimin e asamblesë do të tregojë datën, kohën dhe vendin e takimit, si dhe çështjet e rendit të ditës.

- 15.5 Nëse data për mbledhjen e ardhshme është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qënë prezentë, atëherë do të gjykohet sikur njoftimi është dërguar.
- 15.6 Nëse të gjithë ortakët janë prezentë në Asamblesë e Ortakëve, atëherë vendimet mund të merren dhe në mungesë të përmbushjes së kërkesave formale të caktuara më sipër nëse të gjithë ortakët janë dakord.

#### **Neni 16** **Vendimarrja në Asamblesë e Ortakëve**

- 16.1 Vendimet në Asamblesë e Ortakëve të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme sipas përcaktimeve të nenit 14 të Statutit, mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 % të kuotave të kapitalit të Shoqërisë. Këto vendime do të konsiderohen të vlefshme vetëm nëse këto vendime marrin në favor të tyre mbi 50 % të votave prezente në mbledhje.
- 16.2 Vendimet në Asamblesë e Ortakëve të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas përcaktimeve të nenit 14 të Statutit, mund të merrren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët të cilët zotërojnë më shumë se 50 % e numrit total të votave. Këto vendime do të konsiderohen të vlefshme vetëm nëse këto vendime marrin në favor të tyre të paktën 75 % të votave prezente në mbledhje.
- 16.3 Çdo ortak mund të përfaqësohet gjatë mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve nga një person i caktuar nga ai me prokurë, me anën e së cilës mund të japë votën e tij. Prokura duhet të jetë e noterizuar dhe të paraqitet në mbledhjen e Asamblesë. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamble.
- 16.4 Cdo ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e asamblese, të cilat do të jenë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.
- 16.5 Nëse mbledhja e Asamblese së Ortakëve thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përmbushur kuorumin, atëherë asambleja do të thirret përsëri në përputhje me Nenin 16 dhe gjithmonë jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 17** **Drejtimi i mbledhjes së Asamblesë**

- 17.1 Kryetari i mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve do të caktohet nga ortaku/et me konsensus.
- 17.2 Do të aprovohen apo refuzohen vetëm ato çështje të cilat janë përcaktuar shprehimisht në rendin e ditës për mbledhjen e asamblese. Diskutimet mbi çështje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse të gjithë ortakët japin pëlqimin e tyre.

**Neni 18**  
**Procesverbali i mbledhjes së Asamblesë**

- 18.1 Për çdo mbledhje të Asamblesë së Ortakëve do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Procesverbali duhet të mbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin tregëtar dhe një për secilin ortak. Procesverbalit i bashkangjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së asamblesë.
- 18.2 Procesverbali do të firmoset nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
- 18.3 Kopjet e vendimeve përkatëse të ortakëve do t'u dërgohen ortakëve me letër ose e-mail, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas takimit të ortakëve. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, një kopje e procesverbalit do të publikohet jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes në këtë faqe.
- 18.4 Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesverbalit dhe shpërndarjen e tij.

**PJESA IV**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

**Neni 19**  
**Administrimi i Shoqërisë**

- 19.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një ose më shumë administratorë, të cilët do të përfaqësojnë Shoqërinë. Gjithashtu, Asambleja e Ortakëve mund të caktojë kompetenca përfaqësimi individuale secilit prej administratorëve.
- 19.2 Administratorët nuk mund të autorizojnë palë të treta që t'i përfaqësojnë ata në transaksione të veçanta, pa miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve.
- 19.3 Administratorët do të organizojnë dhe menaxhojnë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë për aq sa Statuti u lejon atyre. Ata janë të autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me të, përveç kur një gjë e tillë kërkon miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve.
- 19.4 Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e Asamblesë së Ortakëve dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 19.5 Administratorët kanë të drejtat e mëposhtme:
- përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
  - hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
  - përfundimin e marrëveshjeve mbi dhënien e huave, vetëm pas miratimit të Asamblesë së Ortakëve;
  - përfundimin e marrëveshjeve të tjera me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;



- nënshkrimin e të gjithë dokumentave, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
- mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrien e paradhënies;
- dhënien e moratoriumit debitorëve të Shoqërisë, heqjen dorë nga paditë që vijnë si pasojë e marrëdhënies të Shoqërisë me palët e treta dhe/ose pranimin e këtyre padive, vetem pas miratimit të Asamblesë së Ortakëve;
- punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
- marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratorët mund të udhëzojnë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërblimit të tyre; administratorët kanë të drejtë të ngrenë padi dhe t'i tërheqin ato, të nënshkruajnë marrëveshje gjyqësore, të mbyllin marrëveshje arbitrazhi, të caktojnë arbitra, të tërheqin paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërprejnë procedimet, vetem pas miratimit të Asamblesë së Përgjithshme;
- administratorët kanë të drejtë marrin cdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti, nëse nje gje e tillë nuk kërkon miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve;
- mbledhjen e shpenzimeve të Shoqërisë;
- administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;
- administratorët janë përgjegjës për përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse dicka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes së ortakëve;
- thirrjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të veçanta;
- publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
- administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
- marrin vendime mbi të gjitha çështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të jashtme, të cilat, sipas Statutit nuk i atribuohen shprehimisht dikujt tjetër.

19.6 Veçanërisht, Administratorët nuk kanë të drejtë të kryejnë asnjë nga veprimet e mëposhtme, pa miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve :

- Të kryejë shitblerje, dhënie me qira ose huapërdorje të pasurive të luajtshme ose të pasurive të paluajtshme të Shoqërisë;
- Blerjen e ndërtesave dhe të drejtave për përdorim toke ose të drejtave të pronësisë mbi tokën, ndërtim, rinovim dhe rikonstrukcionin e ndërtesave dhe strukturave të tjera si edhe kryerjen e ndryshimeve strukturore, shtesave dhe përmirësimeve mbi to;

- dhënien me qira, dhënien me nën qira, hipotekimin, vënien peng apo në uzufukt, dhënien, dhurimin, ofrimin, shitjen, transferimin e cedimin si edhe mënyrat e tjera të disponimit të ndërtesave ose një pjesë të tyre, ose të drejtave personale dhe reale mbi tokën apo ndërtesat dhe/ose asetet e shoqërisë;
- të blejë dhe shesë ose të marrë me qira pasuri të paluajtshme, ndërmarrje, degë ndërmarrjesh;
- të negociojë apo të nënshkruajë kredi, huadhenie, leasing, apo çdo lloj forme tjetër kredie apo huamarrjeje;
- të nënshkruajnë çdo kontratë apo marrëveshje të çdo lloji që angazhon financiarisht Shoqërinë për vlera mbi 5 milion Lekë.

19.7 Personi i mëposhtëm do të caktohet administrator nga Asambleja e Ortakëve për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje:

**Z. Jacques RIZZO**, i biri i **Jean**, shtetas francez, lindur më datë 25/11/1984, në Reims, Francë, banues në Vlorë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit / pasaportës me nr. 160759501335, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar.

## **PJESA V**

### **VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET**

#### **Article 20**

#### **Viti financiar, pasqyrat vjetore financiare**

- 20.1 Viti financiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i parë financiar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.
- 20.2 Në fund të çdo viti financiar, administratorët do të përmbushin detyrat e mëposhtme:
- (a) përgatitjen e një liste të detajuar të aseteve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;
  - (b) përgatitjen e bilancit të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;
  - (c) përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.
- 20.3 Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të Asamblesë së Ortakëve së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm për miratim.

#### **Neni 21**

#### **Fitimi i Shoqërisë**

- 21.1 Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në Shoqëri.

- 21.2 Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore. Bilanci i shoqërisë do të miratohet nga Asambleja e Ortakëve dhe do të dorëzohet në organet tatimore përpara fundit të muajit Mars të vitit pasardhës.

## **PJESA VI PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

### **Neni 22 Prishja dhe Likuidimi**

- 22.1 Shoqëria do të zgjidhet në rastet e mëposhtme:
- (a) vendim i mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve;
  - (b) bashkimi me një shoqëri tjetër;
  - (c) vendimi i gjykatës me juridiksion përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
  - (d) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.
- 22.2 Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.

## **PJESA VII DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 23 Dispozitat e fundit**

- 23.1 Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përpiqen t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridiksion përkatës.
- 23.2 Ligji zbatues është ligji shqiptar.
- 23.3 Ky statut nënshkruhet në 4 (kater) kopje origjinale, sot në Tiranë, 04/11/2022.

### **ORTAKU I VETËM**

### **E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**\*\*\* ALBANIAN RECRUITMENT INTERNATIONAL \*\*\***

**Jacques RIZZO**

*Jacques Rizzo*

(Emër, mbiemër, nënshkrimi)

